

20241933338

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIMIN PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 180/19, 275/19, 31/20, 267/20, 67/22 dhe 79/23) në nenin 11, në paragrafin (2) fjalët "ministër i Punës dhe i Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministër i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë".

Neni 2

Në nenin 12, në paragrafin (4) dhe në nenin 17 fjalët "ministër i Punës dhe Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministër i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë", dhe fjalët "në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës" fshihen.

Neni 3

Në nenin 37, në paragrafin (2), pas fjalës "paraprin" vihet presje dhe shtohen fjalët "publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikave". Në rast se rritja e koston së jetesës ka shenjë negative, pensioni nuk korrigjohet".

Neni 4

Në nenin 40, në paragrafin (2), nenin 69 në paragrafin (3), nenin 107-b në paragrafin (2), nenin 107-e në paragrafin (2), nenin 110 dhe nenin 111 në paragrafin (2) në fjalinë e parë dhe të dytë dhe në paragrafin (4) fjalët "ministri i Punës dhe i Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë".

Neni 5

Në nenin 112, në paragrafin (4) dhe në nenin 117, në paragrafin (3) fjalët "ministri i Punës dhe i Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë", ndërsa fjalët "në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës" fshihen.

Neni 6

Në nenin 117-a paragrafi (2) në pikën 4) fjalët "ministri i Punës dhe i Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë".

Neni 7

Në nenin 117-b në paragrafin (1) në fjalinë hyrëse fjalët "ministri i Punës dhe i Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë".

Në nënparagrafin 2 fjalët "Kabineti i zëvendëskryetarit të Qeverisë, përgjegjës për çështjet ekonomike dhe për koordinim me resoret ekonomike" zëvendësohen me fjalët "Zyra e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Në nënparagrafin 3 fjalët “Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Politikës Sociale, e Demografisë dhe e Rinisë”.

Në nënparagrafin 5, pas fjalëve "Ministria e Ekonomisë" shtohen fjalët "dhe Punës".

Neni 8

Në nenin 125, në paragrafin (6), nenin 126, në paragrafin (3) dhe në nenin 128 në paragrafin (3) fjalët “ministri i Punës dhe i Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët “ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë”, dhe fjalët “në pajtim me ministrin e Shoqërinë Informatike dhe të Administratës” fshihen.

Neni 9

Në nenin 130 në paragrafin (4) dhe në nenin 131 në paragrafët (1) dhe (6) fjalët "ministri i Punës dhe i Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë".

Neni 10

Në nenin 156, paragrafi (2) në nënparagrafin 1 dhe në nenin 157, në paragrafin (2) fjalët "Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Politikës Sociale, e Demografisë dhe e Rinisë".

Neni 11

Në nenin 161, në paragrafin (1) pas pikës 4), shtohet pikë e re 4-a), si vijon:

“4-a) dorëzon për miratim në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut planin vjetor për punën e Fondit, jo më vonë se 1 dhjetori i vitit vijues për vitin e ardhshëm, raport gjashtëmuor për punën e Fondit, jo më vonë se data 31 korrik dhe raport vjetor për punën e Fondit, jo më vonë se data 31 janar për vitin paraardhës”.

Në paragrafin (2) fjalët "Ministria e Shoqërisë Informatike dhe e Administratës" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Administratës Publike”.

Neni 12

Në nenin 162, në paragrafin (2) dhe nenin 164-b në paragrafët (2) dhe (4) fjalët "ministri i Punës dhe i Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë".

Neni 13

Në nenin 185, në paragrafin (4) dhe në nenin 186, në paragrafët (1) dhe (2) fjalët "Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Politikës Sociale, e Demografisë dhe e Rinisë".

Neni 14

Në nenin 193, në paragrafin (4) pas fjalëve "ministri i Ekonomisë" shtohen fjalët "dhe punës", fjalët "ministri i Punës dhe i Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë", ndërsa pas fjalës "financat" presja dhe fjalët "zëvendëskryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për çështje ekonomike” fshihen.

Neni 15

Në nenin 193-c në paragrafin (3) fjalët “ministri i Punës dhe i Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët “ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë”.

Neni 16

Në nenin 194, pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

"(4) Në krijimin, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave dhe dokumenteve në formë elektronike, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme, zbatohen rregulloret nga sfera e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besueshme".

Neni 17

Në nenin 207, në paragrafin (3) fjalët "ministri i Punës dhe i Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë", ndërsa fjalët "në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës" fshihen.

Neni 18

(1) Dispozitat e nenit 37 të këtij ligji nuk zbatohen në periudhë prej 1 shtator 2024 deri më 31 gusht 2025.

(2) më 1 shtator 2024, të gjitha llojet e pensioneve të realizuara në pajtim me këtë ligj përfundimisht me 31 gusht 2024, rriten për 2.500 denarë.

(3) Më 1 mars 2025, të gjitha llojet e pensioneve të realizuara në pajtim me këtë Ligj përfundimisht me 28 shkurt 2025, rriten për 2.500 denarë.

(4) Për shkak të zbatimit të paragrafit (2) dhe (3) të këtij neni, pensioni i realizuar në vitin aktual më parë u reduktua në shumë mujore sipas rritjes të neto rrogave nga dhjetori i vitit paraprak në lidhje me rrogën neto mesatare të vitit të njëjtë,

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.